# FIER, THELBI I STRATEGJISË ANTITRAFIK

NGA XHAVIT SHALA

Interviste për Gazetën Shqiptare[1]

Nëpërmjet kësaj interviste, duke qenë në detyrën e Drejtorit të Policisë Qarkut Fier, kam synuar jo vetëm analizimin e fenomenit të trafikut të qenieve njerëzore, por sidomos prezantimin dhe sigurimin e mbështetjes se opinionit për Strategjinë e Luftës Kundër Trafikut te Qenieve Njerëzore, sidomos te trafikut te femrave me qellim ushtrim prostitucioni.

**Gazeta Shqiptare:** Jeni Drejtor i Policisë se Fierit dhe i njihni nga afër problemet e këtij Qarku. Cila është arsyeja që kjo zonë ka qenë dhe është problematike porsa i përket trafikut të femrave ?

**Xhavit Shala:** Nuk është vetëm kjo zonë, por e gjithë Shqipëria problematike përsa i përket trafikut të femrave. Të ndaluarit nga ana jonë në Qarkun e Fierit për këtë vepër penale janë nga i gjithë vendi. Megjithatë, një përqindje të lartë e ka edhe kjo zonë. Lidhur me shkaqet, mund të them se mungesa e theksuar e punës goditëse të policisë gjatë viteve 92-97, ka bërë që ky fenomen të lulëzojë. Gjatë kësaj periudhe në gjithë Qarkun janë goditur vetëm 45 persona. Në këto kushte, kur çdo gjë mund të bëhej lirshëm, shumë trafikantë u sulën drejt Fierit, Lushnjës e Mallakastrës, ku bënë dhe atë që deshën. Pra kjo është arsyeja kryesore. Varfëria, është një tjetër shkak që i ka detyruar femrat e kësaj zone që të mashtrohen lehtë e të pranojnë të "martohen" për të dalë jashtë shtetit, duke i detyruar më pas të dalin të prostituojnë në rrugë.

**Gazeta Shqiptare:** Keni evidentuar raste që femrat te kenë ikur vetë ?

**Xhavit Shala:** Në shumë prej takimeve që kemi pasur kohët e fundit, prindër të ndryshëm kanë pohuar se e dinë që vajzat e tyre prostituojnë në rrugët e Italisë apo në vendet e tjera. Por tani nuk kane çfarë të bëjnë. Ato kanë ikur dhe familjet "kënaqen" me ato pak para që iu dërgojnë ato. Por ka dhe nga ata që e dinë, por kanë frikë të denoncojnë.

**Gazeta Shqiptare:** Drejtoria juaj ka ndërmarrë një iniciativë të veçantë, atë të ndërgjegjësimit të komunitetit për parandalimin e këtij fenomeni….

**Xhavit Shala:** Po, është e vërtetë që i kemi hyrë kësaj pune, e cila deri tani po ecën mire. Ka qenë një ide e imja. Për këtë me shtynë rezultatet shumë të mira të punës për parandalimin e kultivimit te bimëve narkotike. Pasi kjo rezultoi e suksesshme, ndërmora dhe këtë nismë. Menjëherë pas Konferencës Rajonale për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore filluan takimet në fshatra, komuna,

[1] Intervista në Gazetën Shqiptare është botuar me datë 13.11.2001.

shkolla te mesme dhe gati shtëpi me shtëpi. Deri tani duket se kemi pasur sukses. Në të gjitha fshatrat, komunat apo shkollat na kanë pritur mjaft mirë dhe, pranë nesh, janë grumbulluar gjithmonë nga rreth 100 vetë.

**Gazeta Shqiptare:** Diçka me konkrete rreth këtij plani …

**Xhavit Shala:** Plani strategjik i kësaj pune ndahet ne tre faza. E para është forcimi i goditjes së trafikantëve, gjë e cila që nga 9 shtatori, kur filloi kjo punë ka pasur mjaft sukses. Faza tjetër e këtij plani është dhe ajo që tashmë kemi nisur, pra sensibilizimi i komunitetit jo vetëm parandalimin e mëtejshëm të këtij fenomeni, por dhe për të rritur denoncimet për raste të tilla. Po ashtu, një punë e madhe në goditjen e trafikantëve dhe rrjeteve të tyre do të behet edhe me anën e femrave që do të kapeshin duke ushtruar prostitucion e do të depërtoheshin nga policitë e vendeve perëndimore, si dhe me sensibilizimin e familjeve për t'i pranuar ato në shtëpi. Nëse këto viktima nuk do të pranohen nga familjet e tyre, procesi sërish do të riciklohet, pasi ato do lidhen me trafikantë të tjerë e kështu me radhë. Po ashtu në kuadrin e kësaj strategjie është edhe sensibilizimi i vetë prindërve të vajzave që të denoncojnë tutorët, pasi shumë prej tyre i dinë, por kanë frikë të flasin.

**Gazeta Shqiptare:** Thatë më lart qe do te "shfrytëzoni" femrat e kapura për te zbuluar trafikantet .Ne çfarë mënyre ?

**Xhavit Shala:** Brenda ambienteve te Drejtorisë se Fierit, ka nisur ngritja e një miniqendre me 10 shtretër dhe kushte optimale. Femrat e kapura nga ne, apo janë nga Qarku jone por te kthyera nga policitë e huaja nuk do te dërgohen me direkt ne familje siç ka ndodhur gjithmonë. Atyre do t'u sigurohet strehim dhe mbrojtje. Ne këtë qendër, e cila do te jete gati për një jave, do te strehohen këto femra për një kohe te caktuar. Ato do te pyeten nga policia deri ne detajin e fundit për trafikimin apo rrjetin ku ajo ka qene viktime dhe emrat qe do te na tregoje ajo ,do t'i shpërndajmë ne gjithë vendin, si dhe do t'ia japim Interpolit. Me pas, këto viktima të marra në mbrojtje do te dëshmojnë para një trupi gjykues ato çfarë ka thënë te ne, me qellim qe kur trafikantet te prangosen te mos kemi kthim të dëshmive te vajzave të trafikuara. Pas kësaj pune qe zgjat 10 dite apo dy jave do te bisedojmë me familjen e vajzës, qe ajo ta pranoje atë. Ne te kundërt, po përgatitemi te nënshkruajmë një marrëveshje me ICMC-ne, qe merret me rehabilitimin e viktimave te trafikut, me qellim qe t'i mbaje e sistemoje me pune, qe ato te mbajnë veten. Kështu gjerat do te rrjedhin zinxhir njëra pas tjetrës, deri ne evitimin e plote te këtyre trafiqeve, gjë te cilën shpresojmë shume shpejt dhe mendoj se do te kemi sukses, pasi kemi edhe mbështetjen e komunitetit.

Gazeta Shqiptare 13.11.2001



DREJTORI I POLICISE, RREFEN STRATEGJINE E TIJ PER TA LUFTUAR





# Fieri, ja pse u bë vatër prostitucioni



Gazeta Shqiptare,speciale me 28 Janar 2002



Historia — E martë 28 Janar 2002 — 11

QENDRA E PRITJES SE VIKTIMAVE TE TRAFIKUT NE FIER, SI DHE KUSH JETON NE TE

Në foto: Lart, pamje e jashtme e Qendrës së pritjes së të trafikuarave. Poshtë, pamje e brendshme e njërës prej dhomave

# Një derë gjithnjë e hapur për vajzat e trafikut

Nga i dërguari ynë në Fier

Granit SOKOLAJ

Zhurma e një gjeneratori ndjehet që larg, ndërkohë që komisariati nuk ka drita. Prodhuesi me naftë i energjisë furnizon me dritë dy dhoma, një klasë dhe dushet. Është pikërisht Qendra e Pritjes dhe Mbrojtjes së Viktimave të Trafikut, e ngritur pranë Drejtorisë së Policisë, në qytetin e Fierit. Po kush hyn në këtë qendër? Sa qëndron, si trajtohet, çfarë bën aty dhe ku shkon më pas?

## Historia: Si më rrëmbyen vlonjatët

Gazeta “Koha Jone”   12.12.2001

15

# Kronika

KOHA JONE 12. 12. 2001

## Drejtori i policisë: “Kështu mbrojmë femrat që denoncojnë tutoret”

### *Fier, ngrihet për herë të parë një qendër e pritjes së viktimave të prostitucionit*



Gentian Ruko

**FIER** - Ngrihet për herë të parë në Shqipëri një qendër e pritjes dhe e mbrojtjes së viktimave të trafikut të prostitucionit. Nismëtari i saj, drejtori i policisë së Fierit, Xhavit Shala, thotë se e krijoi atë për të strehuar femrat e rrëmbyera ose të mashtruara për prostitucion. "Qendra, që është ngritur në mjediset e policisë së Fierit, krijon kushtet që këto femra, që kapen gjatë rrugës për jashtë shtetit ose që janë kthyer prej andej, të mos kenë frikë për të denoncuar tutorët e tyre. Dhe kjo është veçanërisht e vlefshme derisa në Shqipëri nuk ka një ligj të posaçëm për mbrojtjen e dëshmitarëve", thotë Shala. Qendra u përurua dje, gjatë një vizite që ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, Geert Ahrens, kreu në drejtorinë e policisë së Qarkut të Fierit. Qëndra është e përbërë nga dhoma me gjithsej 12 shtretër. Ka aty banja, dushe, salla leximi dhe stola për të pushuar. Qendra administrohet nga dy OJQ të Fierit, të cilat kanë caktuar një kujdestare. Kujdestarja ka nën varësi një nënoficere të policisë. Pjesa tjetër e personelit, një mjek dhe një psikolog, është parashikuar për t'u angazhuar me seanca të herëpashershme, sipas nevojave që do të paraqiten. Vajzat e para janë duke e banuar qendrën. Shala sqaron se qendra nuk duhet ngatërruar me një strehë rehabili[illegible]. Por ai siguron se qëndrimi në [illegible] mjaftueshme vajzave të rëna viktimë e trafikantëve që ato të [illegible]mojnë kundër të ashtuquajturve tutorë të tyre, në seancën e sigurimit të provës në gjykatë. Shala thotë se ngulmon që kjo seancë gjyqësore të zhvillohet brenda 10 ditësh, nga momenti që policia përfundon hetimet; në të kundërt qendra nuk mund ti shërbejë mjaftueshëm qëllimit për të cilin është krijuar. Qëkur Shala mori drejtimin e policisë së Fierit, pothuajse nga janari i këtij viti, rreth 100 trafikantë femrash janë ndjekur penalisht, ose 2,5 herë më shumë se një vit më parë.

Ballkan 19 shtator 2001/numri i pare

Kronika

Strategji e re për luftën kundër trafikut të prostitucionit. Ja fazat dhe organizmat që do të bashkëveprojnë

# Plan për parandalimin "e shitjes" së njerëzve



Trafiku nuk luftohet vetëm në Fier

*Në këtë operacionet anti-krim, ku rezultati nuk tregon efektshmërinë e organizmit të policisë, por është pasojë e legalitetit dhe përhapjes së krimit ndeshen edhe forma të organizimit*

Statistika

Metodat e luftës

Parandalimi





Gazeta “Albania” 14. Dhjetor 2001



Një ditë në Qendrën e Pritjes dhe të Mbrojtjes së Viktimave të Trafikut

# Vajza që presin dënimin e tutorëve

U dashurua në moshën 17-vjeçare me një djalë nga Vlora. Në atë kohë ajo jetonte me të ëmën, i ati punonte në Greqi. Nga Levani iu dha mundësia të merrin shtëpi në Skelë të Vlorës. Atje u dashurua me një djalë. I ati solli edhe njerëzit në shtëpi që ta kërkonin për nuse...




TELE-BINGO në TVSH

2 APARTAMENTE

MAGIC-BINGO

2 AUTOVETURA

STAR-BINGO

5 ÇMIME NGA 500.000 leke (te reja)

...dhe plot dhurata te tjera.





Albania Online Internet